

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " RUBIX AGRO " Sh.p.k**

Ne Tirane, sot me date 09.03.2022(dymije e njezet e dy), nenshkruhet ky Akt Themelimi i Shoqerise " **RUBIX AGRO**" Shpk nga: "**Rubix Holding Group**" sh.p.k. shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar si person juridik prane qendres kombetare te regjistrimit Tirane me **NUIS M21508003D** me adresen. **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane.** E cila, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " **RUBIX AGRO**" Shpk.

**Neni 1**

**Forma e shoqerise**

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te Shoqerise, pa iu njojur asnjë pergjegjesi tjeter.

**Neni 2**

**Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise eshte "" **RUBIX AGRO**" Sh.p.k.

**Neni 3**

**Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit te Themelimit.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarise**

Veprimtaria e Shoqerise " **RUBIX AGRO**" Shpk do te ketë për objekt:

Import export dritherash te ndryshme si grure, miser, elb, soje, vajra ushqimor apo cdo lloj produkti apo nenprodukti te tyre. Import export produkte blegtoral si kafshe edhe ne industri perpunuese te industries blegtoreale dhe perpunuese te tyre. Prodhimin dhe tregtimin ne Shqiperi dhe jashte saj te produl:teve ushqimore bimore buqesore dhe te pyllit (te egra) per qellime ushqimore, mjeksore si dhe kozmetike. Te produktave me origjine shtazore dhe produktet qe derivojne nga to qofshin keto blegtoreale apo te egra. Zhvillimin e procesit te perpunimit, transformimit ruajtjes dhe amballazhimit te produktave te siperpermendura dhe produktave qe derivojne nga to me origjine shtazore apo bimore duke i konsideruar nga pikepamja me e gjere e mundeshme. Aktivitetin e import-eksport. Dhenien e konsulences, ndermjetesimit, dhe tregtimit per shoqeri shqipetare apo te huaj, brenda territorit shqiptar ose jashte tij. Shoqëria, me vendim te Administratorit, dhe pas miratimit paraprak te Asamblesë se Pergjithshme, mund te lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje te tjera, si dhe te kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

**Neni 5**

**Selia**

Selia e Shoqerise " **RUBIX AGRO**" Shpk eshte ne adresen: **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane. Shqiperi.**

## **Neni 6**

### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

## **Neni 7**

### **Kapitali i shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise "**RUBIX AGRO**" Shpk eshte 10 000 (dhjetemije) Leke, dhe eshte depozituar ne nje llogari bankare te vecante sipas percaktiveve ligjore. Kapitali do te ndahet ne 1 (nje) kuot. Ky kapital eshtë formuar nga themeluesja e shoqërisë si më poshtë: "**Rubix Hollding Group**" sh.p.k. me 10 000 (dhjetemije) leke duke zotuar 100 % te kuotave 1 (nje kuot).

## **Neni 8**

### **Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem me nje mandat 5(pese) vjecar.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. **Edmond Petraj**

Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

## **Neni 9**

### **Te ardhurat**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne report me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se vitit ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne report me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

## **Neni 10**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykatat e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte hartuar ne 4 kopje ne gjuhen Shqipe dhe nenshkruehet rregullisht nga ortaku themelues.

**ORTAKET THEMELUES: "Rubix Hollding Group"**

**Administratori Edmond Petraj**



## **STATUTI I SHOQERISE " RUBIX AGRO " Sh.p.k**

### **NENI 1**

#### **Emertimi dhe Forma e Shoqërisë**

- 1.1 " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k themelohet në formën e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i kesaj shoqerie do te rregullohet nga ky Statut dhe nga ligji nr. Nr.9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- 1.2. Emërtimi " **RUBIX AGRO** " Sh.pk dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe qeë u drejtohen të tretëve.
- 1.3. Shoqeria " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e rregistritimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

### **NENI 2**

#### **Dokumentat Rregullues**

- 2.1. Dokumenti kryesor mbi te cilin bazohet aktiviteti i Shoqerise " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k është Statuti i saj. Me ane te ketij Statuti dhe ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe me legjislacionin shqiptar, rregullohet pozita juridike e Ortakeve dhe punonjesve te Shoqerise, organizimi dhe objekti i veprimtarise se Shoqerise dhe çeshtjet e tjera me rëndësi për aktivitetin e saj.
- 2.2 Per çeshtjet qe nuk zgjidhen nga Statuti, Asambleja e Pergjithshme mund të miratojë një Rregullore të Veçantë.
- 2.3. Statuti dhe Rregullorja e veçantë janë dokumenta të hapura për ndryshime dhe përmirësimet që zhvillimet i bëjnë të nevojshme.

### **NENI 3**

#### **Ortaku**

- 2.1 Ortak i " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k eshte: "**Rubix Holding Group**" sh.p.k. shoqeri tregetare e regjistruar si person juridik prane qendres kombetare te regjistrimit Tirane me NUIS M21508003D me adresen. **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane.**

### **NENI 4**

#### **Selia**

- 4.1. Shoqeria " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane.**
- 4.2. Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tille mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj. te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojne nen mbikqyrjen e Administratorit të " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k.

## NENI 5

### Vula, Stema

- 5.1. Shoqeria " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k "ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj.
- 5.2. Stema e " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k duhet te figuroje ne te gjithe materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare te Shoqërisë.

## NENI 6

### Kohezgjatja

- 6.1. Shoqeria do te zhvilloje veprintarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

## NENI 7

### Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

- 7.1. Shoqëria " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, rregullave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

7.2. Veprimtaria e Shoqërisë " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k, do të ketë për objekt:

Import export dritherash te ndryshme si grure, miser, elb, soje, vajra ushqimor apo cdo lloj produkti apo nenprodukti te tyre. Import export produkte blegtorale si kafshe edhe ne industri perpunuese te industries blegtorale dhe perpunuese te tyre. Prodhimin dhe tregtimin ne Shqiperi dhe jashte saj te produkteve ushqimore bimore bujqesore dhe te pyllit (te egra) per qellime ushqimore, mjeksore si dhe kozmetike. Te produkteve me origjine shtazore dhe produktet qe derivojne nga to qofshin keto blegtorale apo te egra. Zhvillimin e proçesit te perpunimit, transformimit ruajtjes dhe amballazhimit te produkteve te siperpermendura dhe produkteve qe derivojne nga to me origjine shtazore apo bimore duke i konsideruar nga pikepamja me e gjere e mundeshme. Aktivitetin e import-eksport. Dhenien e konsulences, ndermjetesimit, dhe tregtimit per shoqeri shqipetare apo te huaj, brenda territorit shqiptar ose jashte tij. Shoqëria, me vendim të Administratorit, dhe pas miratimit paraprak të Asamblesë së Pergjithshme, mund të lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

## NENI 8

### Kapitali i Shoqerise

- 8.1. Kapitali themeltar i shoqerise " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k eshte 10 000 (dhjetemije) Leke, dhe eshte depozituar ne nje llogari bankare te vecante sipas percaktiveve Kapitali do të ndahet në 1(nje) kuot. Ky kapital është formuar nga themeluesja e shoqërisë si më poshtë: "**Rubix Hollding Group**" sh.p.k. me 10 000 (dhjetemije) leke duke zotëruar 100 % të kuotave.

## NENI 9

### Organet drejtuese

- 9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose perfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratori.

## **NENI 10**

### **Asambleja e pergjithshme**

10.1. Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshmee merr vendime per ceshtjet qe ligii apo ky statut ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

10.2. Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k

10.3. Perveç rasteve të miratimit të llogarive vjetore si dhe ndryshimeve të Statutit, Asambleja mund te marre vendime edhe me ane te konsultimit me shkrim te ortakeve. Administratori ka të drejtën e zgjedhjes se formës së marrjes së vendimit ndërmjet mbledhjes së Asamblesë ose konsultimit me shkrim.

## **NENI 11**

### **Marrja e vendimeve**

11.1. Çdo ortak, pavarësisht nga numri i pjesëve të kapitalit që zotëron. ka te drejte te marrë pjese ne mbledhjet dhe ne vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

11.2. Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne keto mbledhje nga nje ortak tjeter ose nga nje mandatmbajtes i cili mund te votoje ne emer te atij qe perfaqeson. Mandati i përfaqësimit nuk mund të jetë i përhershëm. por jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë. Mandati i dhënë për një mbledhje të Asamblesë është i vlefshëm për mbledhjet e tjera, që thirren si vazhdim i së parës dhe me të njëjtin rend dite.

## **Neni 12**

### **Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve**

12.1. Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- a. ndryshimit të Statutit;
- b. riorganizimi i shoqerise. ndarja, bashkimi, likujdimi;
- c. linjat baze per zhvillimin e akti vitetit te Shoqerise;
- d. zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- e. miratimi i llogarive, raportit vjetor, inventaret, rapporti i eksperteve kontabel te autorizuar,
- f. hapja e filialeve, degeve apo zyrave te reja;
- g. marrja hua, lenja peng apo çdo barre tjeter siguruese;
- h. hapja e nje aktiviteti te ri ekonomik;
- i. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese;
- j. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- k. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- l. blerja e pasurive te paluajtshme; me blerja e aksioneve, certifikatave apo titujve te shoqerive te tjera tregtare, apo e çdo lloj instrumenti financiar, ne. Prishjen e Shoqerise
- o. Shnderimin e Shoqerise në një formë tjetër;
- p. vendos per vendet e punes, detyrat dhe shperblimet perkatese;
- q. si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose ky Statut i jasin shprehimisht Asamblese.

## NENI 13

### Administratori i Shoqërisë

13.1. Shoqeria administrohet nga Administratori. një person fizik që mund te jetë ose jo ortak i Shoqerise.

13.2. Administratori është i detyruar te drejtojë Shoqërinë " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k në përputhje me ligjin « Për tregtaret dhe Shoqërítë Tregtare », ketë Statut, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

## NENI 14

### Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit

14.1. Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë prej 5(pese) vjetesh.

14.2. Administratori i pare i shoqerise eshte **Z. Edmond Petraj**

14.3. Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

## NENI 15

### Kompetencat e Administratorit

15.1. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te Shoqerise " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k me perjashtim te atyre kompentencave qe ligji dhe/ose ky Statut i japid shprehimisht Asamblese së Pergjithshme. Ndryshimi i kompetencave te Administratorit vendoset me unanimitet nga Asambleja e Pergjithshme.

15.2. Administratori ka te drejte te perfaqesoje Shoqerine para te treteve dhe te gjitha vendimet manaxheriale te Shoqerise " **RUBIX AGRO** " Sh.p.k duhet te nenshkruhen te pakten nje nga Administratori.

15.3. Asambleja e Ortakëve mund t'i jape autorizim paraprak Administratorit për kryerjen e operacioneve të caktuara ose lidhjen e kontratave të cilat konsiderohen tepër të rëndësishme për Shoqërinë.

## NENI 16

### Mosmarreveshjet

16.1. Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimitarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi komponent do te jetë Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

16.2. Ky Statut redaktohet ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me vullnetin e tij te lire nga ortaket themelues.

### ORTAKET THEMELUES

**"Rubix Hollding Group" sh.p.k.**  
**Administratori - Edmond Petraj**

